



BULETINI

SHKURT 2022

Komuna e Lipjanit

KOMUNA E LIPJANIT – ZYRA PËR INFORMIM

☎ 0 800 14 000 / 038 200 41 508

✉ infokomuna.lipjan@rks-gov.net

KK-LIPJAN
SCAN



Rr.Shqipëria nr: 28, 14000 Lipjan, Kosovë

Kryetari Imri Ahmeti ka pritur Shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë, ambasadorin Tomas Szunyog

Kryetari i Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti, ka pritur në takim shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, me të cilin kanë diskutuar një mori çështjesh, me fokus të veçantë kanë diskutuar për marrëveshjen e gjelbërt dhe mbrojtjen e mjedisit. Kryetari Ahmeti fillimisht vlerësoi lart bashkëpunimin dhe kontributin e Bashkimit Evropian për implementimin e disa projekteve në Komunën e Lipjanit.

“Falenderoj Ambasadorin Szunyog për interesimin e tij në vazhdimin e punëve të përbashkëta, ku edhe në këtë rast biseduam edhe për investimet e mundshme rreth marrëveshjes së gjelbërt dhe ruajtjen e mjedisit në mënyrë që të kontribohet në shëndetin e qytetarëve” ka thënë ndër të tjera Kryetari Imri Ahmeti.

Ndërkaq, Shefi i Zyrës së BE-së, ambasadori Szunyog ka shprehur mirënjohje Kryetarit Imri Ahmeti, duke uruar për mandatin e ri dhe çmoi lart përvojën e tij si lider, ai po ashtu çmoi lartë edhe për frymën bashkëpunuese dhe rikonfirmoi gatishmërinë për bashkëpunim edhe në të ardhmen.

“Janë investuar mbi 1 milion euro në projektet e ndryshme të Komunës së Lipjanit dhe jemi të interesuar të vazhdojmë me investime tjera, ku sot po ashtu diskutuam me komunën rreth projekteve të marrëveshjes së gjelbërt dhe mbrojtjen e mjedisit, ka thënë Shefi i Zyrës së BE-së, ambasadori Szunyog, duke shtuar se çmoi faktin që Komuna e Lipjanit është shumë etnike dhe jetojnë disa komunitete, ne së bashku me UNDP së shpejti do të fillojmë për të implementuar projektin për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në Janjevë.

Kryetari Ahmeti dhe Ambasadori Szunyog janë pajtuar për fuqizimin e projekteve të përbashkëta në interes të qytetarëve të Komunës së Lipjanit.



Shtabi Emergjent mban takimin e radhës, mbi 60 mijë doza të administruara

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, Diamant Bytyqi ka mbajtur takim me Komitetin Komunal për Reagim Emergjent. Në këtë takim është diskutuar për situatën aktuale dhe veprimet preventive nga COVID-19, rastet e reja me Omicron dhe masat tjera në Komunën e Lipjanit.

Drejtori i Shëndetësisë Shkelzen Hajdini ka dhënë informatë në lidhje me situatën me Covid-19 ku është theksuar se deri më tani janë administruar mbi 60 mijë vaksina.

Po ashtu, gjatë këtij takimi Komandanti i Stacionit të Policisë në Lipjan, Naser Sinani ka falënderuar institucionet komunale për bashkëpunimin e treguar si dhe masat që janë duke u zbatuar në gjithë territorin e Komunës së Lipjanit. Nga QKMF është bërë e ditur mbi gjendjen e pacientëve dhe procesin e vaksinimit ndërsa nga Drejtoria e Arsimit është folur rreth Covid-19 në institucionet arsimore si dhe ndikimit të pandemisë në arsim. Në këtë takim po ashtu është bërë thirrje që të zbatohen të gjitha masat e marra konformë vendimit të Qeverisë.

Nënkryetari Bytyqi ka falënderuar personelin Shëndetësor, Policinë e Kosovës, Inspektoratin dhe të gjithë ata që janë në front me virusin Covid-19, që po bëjnë një punë të madhe për menagjimin e kësaj situate.

Administrimi i vaksinave deri me datë 09.02.2022: Doza e parë 31644 / Doza e dytë 27155 / Doza e tretë 2091 // Gjithsej 60890



Është mbajtur seanca e jashtëzakonshme Kuvendit Komunal e thirrur nga Opozita, lidhur me gjendjen në QKMF, pas zhvillimeve të fundit atje.

Gjatë kësaj seance pas shumë diskutimeve Kryetari Imri Ahmeti ka thënë se zhvillimet e fundit në QKMF dhe rastin në fjalë janë duke u marrur hetuesia dhe se shërbimet në QKMF janë duke vazhduar normalisht, duke vlerësuar lartë kontributin e mjekëve që po bëjnë.

Pas shumë pyetjeve të ngritura nga antarët e Kuvendit, Drejtori i Shëndetësisë Shkelzen Hajdini ka sqaruar të gjitha temat në lidhje me këtë rast. Në fund të kësaj seance është propozuar një deklaratë lidhur me gjendjen në QKMF, pas zhvillimeve të fundit atje, ku me shumicë votash nuk është miratuar!



Në sallën e Kuvendit Komunal të Lipjanit, Grupi i Grave ka filluar takimet për t'i kordinuar aktivitetet e ardhshme gjatë vitit 2022.

Në të njejtën kohë janë diskutuar edhe propozimet e shumta për fuqizimin dhe avansimin e gruas në shoqëri e sidomos gruas lipjanase.



Nënkryetari i Komunës për Komunitete Lulzim Qerimi i shoqëruar me bashkëpunëtorë të tjerë nga Komuna e Lipjanit kanë qenë pjesë të takimit Ngritja e kapaciteteve të institucioneve lokale dhe të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë për të identifikuar, raportuar dhe trajtuar praktikat diskriminuese në Kosovë, Organizuar nga Programi për të Drejtën Civile në Kosovë në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit.



Përkujtohet Xhevdet Hasan Breznica

Në përvjetorin e rënjes së Dëshmorit, Xhevdet Breznica, Nënkryetari i Komunës Diamant Bytyqi me bashkëpunëtor kanë bërë homazhe pranë lapidarit në fshatin e lindjes në Dobrajë të Madhe.



Komiteti për Politikë dhe Financa mbajti mbledhjen e dytë të rregullt
Udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Daut Azemi është mbajtur mbledhja e
dytë e KPF-së me ç'rast janë diskutuar pikat e rendit të ditës që ishin të paraparë për këtë
mbledhje.

Anëtarët e KPF-së pas diskutimeve që patën për secilën pikë veç e veç aprovuan dhe rekomanduan
të gjitha pikat për mbledhjen e Kuvendit e cila do të mbahet të hënën 28.02.2022.



Kuvendi Komunal i Lipjanit nën udhëheqjen e Kryesuesit Daut Azemi ka zhvilluar punimet e mbledhjes së pestë, mbledhje kjo në të cilën u aprovuan të gjitha pikat e rendit të ditës të cilat u propozuan për shqyrtim gjatë kësaj seance.

Fillimisht Kryetari Imri Ahmeti ka dhënë sqarime në të gjitha qështjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

Gjatë kësaj seance është aprovuar, propozim vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2021, propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit për vitet 2020 dhe 2021 në vitin 2022, propozim vendim, propozim vendim për aprovimin e rezervës komunale 2022, propozim vendim për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Lipjanit, Propozim vendim për fillimin e procedurës për përmasimin dhe harmonizimin e mospërputhjeve të vlerave të veçanta teknike të caktuara në Hartën Zonale të Komunës, dhe propozim vendim për formimin e komisionit të ankesave.



Ka përfunduar renovimi i njërës prej objekteve banesore, renovim ky në kuadër të projektit - Subvencione për Eficiencë të Energjisë.

Ky projekt është duke vazhduar edhe te ndërtesat tjera dhe është zbatuar nga Fondacioni i Sfidat e Mileniumit të Kosovës.



**FOTOLAJM/ Komuna e Lipjanit vazhdimisht po bënë pastrimin e rrugëve nga bora pas të reshurave të fundit në vend.
Po ashtu bëjmë lutje për qytetarët për kujdes të shtuar në komunikacion.**



FOTOLAJM/ Shumë shpejt do të jetë në funksion objekti i ri i administratës në Komunën e Lipjanit

Objekti i ri do të ofrojë edhe një standard të ri të ofrimit të kushteve dhe nevojave të administratës komunale dhe shërbimeve ndaj qytetarëve.



FOTOLAJM/ Po vazhdojnë punimet në rregullimin e çerdhës në fshatin Sllovi Drejtori i Infrastrukturës Sead Aliu ka inspektuar punët që janë bërë dhe ka pohuar se shumë shpejt do të përfundojnë punimet në këtë çerdhe e cila do të jetë me standarde të larta dhe kushte moderne, e cila do të shërbejë për edukimin e fëmijëve.



Hapet ekspozita “E duam Kosovën”

Me moton “E duam Kosovën” në bibliotekën e qytetit u hap ekspozitë me piktura nga nxënësit e shkollave të qyteti të Lipjanit, organizuar në kuadër të aktiviteteve të ndryshme për shënimin e 14-të vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Aktiviteti është organizuar nën patronatin e Kryetarit të Komunës, Imri Ahmeti dhe ekspozita do të vazhdoj të qëndroj e hapur gjatë gjithë ditës së sotme.



Kryetari Imri Ahmeti së bashku me bashkëpunëtor kanë bërë homazhe pranë shtatorës së Komandantit Legjendar “Adem Jashari” për nder të 14 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.



Në Komunën e Lipjanit mbahet seancë solemne me rastin e 14 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës
Për nderë të 14 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, në Sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, është mbajtur mbledhje solemne, e cila është hapur nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës Daut Azemi.

Ndërsa, Kryetari i Komunës Imri Ahmeti në fjalën e tij ka thënë se kur sot festojmë Ditën e Pavarësisë, Republikës, sonë pashmangshëm i referohemi të kaluarës tonë të lavdishme, që e kaluam si shoqëri me gjithë ato sakrifica sublime të gjeneratave të tëra për të shënuar këtë ditë, për liri, pavarësi dhe shtetësi.



Mbahet program artistik i ditës së Pavarësisë

Nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti po vazhdojnë aktivitetet kulturoro – artistike për nderë të 17 Shkurtit, Ditës së Pavarësisë së Kosoës.

Në qendrën kulturore “Tahir Sinani”, gjatë ditës është mbajtur programi artistik i Ditës së Pavarësisë, me këngë e valle të ndryshme nga nxënësit e shkollave të qytetit.

Ky program është përgatitur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.



Me rastin e shënimit të 17-të shkurtit, Ditës së Pavarësisë së Kosovës, në sheshin "Adem Jashari" në Lipjan u hap panairi një ditor për promovimin e ushqimeve tradicionale dhe perimtarisë.
Ky aktivitet është mbështetur nga zyra e Kryetarit, Imri Ahmeti dhe është organizuar nga Grupi i Grave në Lipjan në bashkëpunim me gratë fermere të komunës sonë.



Për nder të 14 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, Kryetari Imri Ahmeti ndan mirënjohje për Kampionen e Karatesë Antoneta Budakova, për kontributin e jashtëzakonshëm në sportin e karatesë gjatë vitit 2021.



Me rastin e shënimit të 17-të shkurtit, Ditës së Pavarësisë së Kosovës, në sheshin “Adem Jashari” në Lipjan u hap panairi një ditor për promovimin e ushqimeve tradicionale dhe perimtarisë.
Ky aktivitet është mbështetur nga zyra e Kryetarit, Imri Ahmeti dhe është organizuar nga Grupi i Grave në Lipjan në bashkëpunim me gratë fermere të komunës sonë.



**Në Lipjan përfundon turneu “Kupa e Pavarësisë 2022”, triumfon ekipi Market
Tori**

Me rastin e 17 shkurtit, Komuna e Lipjanit ka organizuar një varg aktiviteteesh kulturo-sportive. Në kuadër të këtyre aktiviteteve të shumta, në palestrën sportive në Lipjan, ka përfunduar turneu tashmë tradicional në futboll të vogël ku vendi i parë i takoi ekipit Market Tori , ndërsa vendi i dytë ekipit Bavarezët.

Të pranishëm në këtë organizim ishte edhe Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti me bashkëpuntorë ku ndau qmimet për ekipet fituese.



Skitari Albin Tahiri nderohet me mirënjohje nga Kryetari Imri Ahmeti
Kryetari Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti ka ndarë mirënjohje për skiatorin
Kosovar Albin Tahiri për përfundimin me sukses dhe rezultatet e treguara në
garën e slallomit të madh në Lojërat Olimpike Dimërore “Pekini 2022”.
Kryetari Ahmeti ka thënë se është ndjenjë e veçantë për Lipjanin që ka djem
që me sukseset e tyre na bëjnë të ndihemi krenar.
Për skitarin tonë është pozita më e mirë në karrierën e tij në Lojërat Olimpike
Dimërore dhe po ashtu rezultati më i mirë për Kosovën.



Nën patronatin e Kryetarit të Komunës Imri Ahmeti, ka filluar turneu tashmë tradicional në futboll të vogël "Kupa e Pavarësisë 2022", aktivitet i cili po mbahet për nderë të 17 Shkurtit, Ditës së Pavarësisë së Kosovës.

Për këtë turne është shprehur një interesim shumë i madh ku janë paraqitur gjithësej 52 ekipe dhe ndeshjet e xhiros së parë po zhvillohen sipas shortit të hedhur para disa dite.

Finalja e këtij turneu do të mbahet më 17 Shkurt me rastin e shënimit të Ditës së Pavarësisë.



Është mbajtur debat publik lidhur me Planin e Veprimit Rinor Lokal Lipjan 2022-2024. Gjatë këtij takimi Nënkryetari Komunës së Lipjanit, Diamant Bytyqi ka thënë se ky takim është shumë i rëndësishëm për të diskutuar mbi planin e veprimit rinor lokal, duke mundësuar po ashtu sa më shumë aktivizimin e rinisë viteve në vijim. Gjatë këtij takimi, nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport është bërë prezantimi i këtij plani që është hartuar nga Komuna e Lipjanit në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, etj. Po ashtu, në vazhdim nga pjesëmarrësit në këtë takim, përfaqësues të OJQ-ve, antarë të Kuvendit Komunal dhe të tjerë janë dhënë disa sugjerime që duhet përfshirë në këtë plan. Ky takim është organizuar nga OSBE.



Nxënësit e sh.f.m.u “Vëllezërit Frashëri”, në Lipjan u shpërblyen me tri medalje në garat ASEF të orgnizuar në Tiranë

Edhe në këtë vit, si dhe në dy vitet paraprake nxënësit e shkollës fillore të mesme të ulët “Vëllezërit Frashëri”, në Lipjan të talentuar në fushën e robotikës nën përkujdesjen dhe mentorimin e arsimtarit Hajriz Rashiti kanë marrë pjesë në garat ndërkombëtare ASEF (Albanian Science Education and Fair) organizuar në Tiranë.

Pjesmarrës ishin mbi 800 garues nga katër shtete (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut dhe Mali i Zi) në kategori të ndryshme. Nxënësit nga shfmu “Vëllezërit Frashëri”, morren pjesë me tri projekte inovative në kategorinë Robotikës and Science të ideuara dhe realizuara nga vetë ata karshi situatave të kohës dhe nevojave të komunitetit.

Këto projekte u çmuan shumë si nga juria po ashtu edhe nga të pranishmit dhe të tri projektet u vlerësuan me medalje. Urime nxënësve dhe mësimevëdhënësve lipjanas për këtë sukses të tillë.



Kryetari Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti ka pritur në takim përfaqësuesit e Shoqatës Sindikale e Punonjësve Social e cila vepron në kuadër të Sindikatës së Shërbimit Civil të Kosovës.

Gjatë këtij takimi është diskutuar rreth kushteve të punës në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, fuqizimi i Qendrave për Punë Sociale (ngritja e kapaciteteve) dhe rrezikshmëria në punë dhe kujdestaria (puna jashtë orarit të rregullt)



